



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
KRYETARI

URDHËR

Nr. 51, datë 28.03.2017

“MBI PLOTËSIMIN E FORMULARIT BASHKANGJITUR
KËRKESAVE PËR GJYKIM”

Bazuar në Ligjin Nr. 98 datë 06.10.2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 37 gërma “dh”, që parashikon kompetencat e Kryetarit të Gjykatës, në nenin 5, pika “4”, të ligjit nr. 98/2016, për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor, sipas të cilit gjykatat funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase; në nenin 3 të ligjit Nr. 96/2016, datë 06.10.2016 (Vlerat themelore), sipas të cilit magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte dhe në kohë të arsyeshme si dhe në zbatim të neneve 154, 141/2, 144 dhe 129 të K.Pr.Civile i ndryshuar me Ligjin Nr. 122, datë 18.04.2013 që bën fjalë “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”,

URDHËROJ

- Plotësimin e “FORMULARIT PËR TË DHËNAT E KONTAKTIT” nga ana e paditësit/kërkuesit/dorëzuesit, formular i cili do t’i bashkëngjitet kërkesës/kërkesë padisë/ankimit që në momentin e dorëzimit të saj pranë sporteleve të K/sekretarisë, në të kundërt nga Gjykata do të vendoset kthimi i akteve, sipas nenit 154/a të K.Pr.Civil.
- Urdhërohen, Kancelari, K/sekretarja e dhomës civile dhe Sekretarja e pranimit të këtyre kërkesave për zbatimin e këtij urdhri.
- Publikimi i këtij urdhri të bëhet në faqen zyrtare të gjykatës dhe në stendat e afishimit të njoftimeve në ambientet e gjykatës.
- Ky urdhër hyn në fuqi në datën 01.04.2017.

KRYETARE

ENKELEDI HAJRO